



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
AUTORITETI PORTUAL DURRËS

**PROCESVERBAL- Tipi i kontratës – e hapur e thjeshtuar - Shërbime**

**PËR ARGUMENTIMIN DHE MIRATIMIN E SPECIFIKIMEVE TEKNIKE DHE  
KRITEREVE PËR KUALIFIKIM**

OBJEKTI I PROCEDURËS: “*Aksesorë Specifike për zyrën e lejeve*”

**VLERA E FONDIT LIMIT:**

2.034.000 ( dy million e tridhjet e katermijë )lekë ,pa TVSH

**1. Për kapacitetin ekonomik dhe financiar:**

**1.1** Për të provuar kapacitetet financiare dhe ekonomike, operatorët ekonomikë duhet të paraqesin vërtetim për xhiron vjetore të realizuar për tre viteve e fundit financiare (2020-2021-2022), ku vlera e xhiros minimale vjetore, për të paktën një nga vitet e periudhës së kërkuar, të jetë në një vlerë jo më të vogël se 40% e vlerës së fondit limit të kontratës që prokurohet.

***Argumentimi:***

*Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në vlerën e fondit limit të kësaj procedure, si dhe bazuar në nenin 77, pika 3, e LPP, si dhe nenin 43, pika 2/b të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, të ndryshuar.*

*Përcaktimi i viteve të kërkuara për paraqitjen e vërtetimit të xhiros vjetore është bërë bazuar ligjit nr. 8438, datë 28.12.1998 "Për tatimin mbi të ardhurat", i ndryshuar, Udhëzimit të Ministrit të Financave nr.5, datë 30.01.2006, "Për tatimin mbi të ardhurat", i ndryshuar, si dhe kërkesave të ligjit Nr. 25/2018 “Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare”.*

*Vlera e xhiros së kërkuar është vendosur duke pasur në konsideratë objektin e kontratës, natyrën dhe volumin e saj. Vlera e xhiros është vendosur që t'i shërbejnë autoritetit kontraktor për njohjen e gjendjes dhe kapaciteteve të operatorëve ekonomikë, të cilët, nëpërmjet dokumentacionit të paraqitur duhet të vërtetojnë se zotërojnë kapacitetet e nevojshme, gjithçka në funksion të realizimit me sukses të kontratës.*

## 2. Për kapacitetin teknik:

**2.1** Operatori ekonomik duhet të paraqesë dëshmi për furnizimet e mëparshme të ngjashme, të kryera gjatë tre viteve të fundit nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës, në një vlerë jo më të vogël se 20 % nga vlera e përlogaritur e fondit të limit të kësaj kontrate.

Për të vërtetuar përvojën e mëparshme të ngjashme, operatorët ekonomikë duhet të paraqesin dëshmitë e mëposhtme:

- Si dëshmi për përvojën e mëparshme kërkohen **vërtetime** të lëshuara nga një ent publik ose **fatura tatimore** të shitjes, ku shënohen datat, shumat dhe sasi të furnizimeve të realizuara. Faturat të jenë të deklaruara në organet tatimore.
- Në rastin e përvojës së mëparshme të realizuar me sektorin privat, si dëshmi pranohen vetëm **fatura tatimore** të shitjes, ku shënohen datat, shumat dhe sasi të furnizimeve të realizuara. Faturat të jenë të deklaruara në organet tatimore.

### **Argumentimi:**

*Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77 të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe nenit 41, pika 3 të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, të ndryshuar. Me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë përvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën me sukses, prandaj është kërkuar që kontratat e mëparshme të ngjashme të jenë në vlerën jo më pak se 40 % të vlerës së fondit limit, që është brenda vlerës kufi të përcaktuar në nenin e sipërcituar.*

*Përvoja e mëparshme është një element shumë i domosdoshëm që garanton autoritetin kontraktor se operatorët ekonomikë mbi bazën e vlerës së kontratave të ngjashme zotërojnë kapacitete për të zbatuar kontratën me sukses sipas një standarti të përshtatshëm cilësie. Në mbështetje të nenit 88 pika 1 e VKM 285/2021, parashikon se “Oferta mund të paraqitet nga një bashkim operatorësh ekonomikë, sipas përcaktimit të pikave 2 dhe 3, të nenit 14, të LPP-së, ku njëri prej të cilëve i përfaqëson të tjerët gjatë procedurës dhe, në rast përzgjedhjeje, edhe gjatë zbatimit të kontratës. Në ofertë duhet të përcaktohet pjesa e shërbimit, punës ose furnizimit, që do të kryejë secili nga anëtarët e këtij bashkimi nëpërmjet një kontrate bashkëpunimi të hartuar ndërmjet palëve.*

**2.2** Operatori Ekonomik duhet të paraqesë certifikatat perkatëse të vlefshme të ISO-ve, (të perkthyer në shqip dhe të noterizuara) të lëshuara nga organizmat e vleresimit të konformitetit, të akredituara nga DPA, ose organizma ndërkombetare akreditues të njohur nga Republika e Shqipërisë, si më poshtë:

- a) Certifikim i Operatorit Ekonomik per ISO 9001; ose ekuivalent** i cili duhet të perkojë me kategorinë dhe specifikën e produkteve dhe të shërbimeve që prokurohen.

- b) Certifikim i Operatorit Ekonomik per ISO 27001; ose ekuivalent** i cili duhet te perkoje me kategorine dhe specifiken e produkteve dhe te sherbimeve qe prokurohen.

**Argumentimi:** Kërkesat e mësipërme janë përcaktuar bazuar në nenin 79, të ligjit nr.162/2020, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe nenin 44 të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”.

Me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që si kompani kanë kualifikimet/certifikimet e duhura organizative dhe operacionale të nevojshme për të zbatuar kontratën.

*Përmbushja e standartit ISO 9001 ose ekuivalent është i rendesishem per te siguruar menaxhimin e cilësisë së shërbimeve që kerkohen. Ky lloj certifikimi garanton Autoritetin Kontraktor se Operatori Ekonomik ka të implementuar një sistem menaxhimi të cilësisë për shërbimet e ofruara dhe zbatimin e kontratës në tërësi e rrjedhimisht dhe përmbushjen e saj sipas të gjitha standarteve të cilësisë.*

*Certifikimi ISO 27001 ose ekuivalent shërben për të verifikuar dhe garantuar qe OE është në gjendje të kryeje realizimin e kontratës duke siguruar qe informacionet te menaxhohen në mënyrë të sigurtë duke qene se sistemi perpunon dhe administron informacione dhe te dhena te rendesishme dhe sensitive . Ky certifikimi garanton Autoritetin Kontraktor se Operatori Ekonomik ka standartet nderkombëtare të duhura për menaxhimin e sigurisë së informacionit gjatë zbatimit të kontratës.*

**2.3 Autorizimi i prodhuesit** per zerat 1) Karta RFID 2) Kartona per leje ditore. Autorizimi duhet te leshohet ne emer te Autoritetit Kontraktor dhe duhet te permbaje te dhena te plota kontakti per te mundesuar verifikimin ne cdo kohe nga ana e Autoritetit Kontraktor.

**Argumentimi:**

*Autorizimi i prodhuesit është një dokument i rëndësishëm, pasi përveçse tregon kanalën zyrtar të origjinës së mallrave/licensimeve specifike që kërkohen në kete prokurim, garanton gjithashtu se ofertuesi është i autorizuar për territorin e Shqipërisë për ofrimin tek AK të këtyre produkteve. Kjo garanton qe produktet që kërkohen të blihen janë prodhuar/krijuar sipas standardeve të larta nga prodhues të njohur zyrtarisht. Kjo kërkesë i shërben autoritetit kontraktor për tu garantuar qe Operatori Ekonomik ka mbështetjen dhe suportin e prodhuesit për të garantuar cilësinë e produkteve dhe furnizimin e tyre në kohë për përmbushjen me sukses të kontratës, duke garantuar funksionimin e pajisjeve në kushtet e garancisë dhe pas saj.*

*Ky kriter është në përputhje me nenin 77, pika 4, të Ligjit Nr. 162/2020, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe pikën 5 dhe 6, të nenit 40, të VKM Nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, të ndryshuar.*

**2.4 Ofertuesi duhet te provoje qe artikujt "Karta RFID" jane ne perputhje me standardet e sistemit te kontrollit te hyrjes ku do te perdoren.**

**Argumentimi:**

*Perputhja e produktit te kerkuar “Karta RFID” me sistemin e parkimit te instaluar ne ambientet e Autoritetit Kontraktor eshte kerkuar pasi kjo lidhet ngushtesisht me mire operimin e sistemin e parkimit te instaluar.*

**2.5** Operatori ekonomik ofertuesi duhet te paraqese te plotesuar ne menyren e duhur tabelen sipas Specifikimeve Teknike. Oferta teknike duhet te kete dokumentat e meposhtme:

- Prezantim te produkteve te ofruara; si dhe
- Pergjigje nje-per-nje te kerkesave teknike pjese e DST; Ne pergjigjet teknike ofertuesi duhet te paraqese referenca ne dokumentat standard te produktit/pajisjeve. Per kete ofertuesi nuk duhet te kufizohet ne dorezimin, konfirmimin “copy-paste” te kerkesave, por duhet te beje argumentimin perkates. Pergjigjet “copy-paste” nuk do te pranohen.

**Të gjithë dokumentat duhet të jenë origjinalë ose kopje të noterizuara të tyre. Rastet e mos-dorëzimit të një dokumenti, ose të dokumentave të rreme e të pasakta, konsiderohen si kushte për skualifikim.**

**Argumentimi:**

*Specifikimet teknike janë hartuar duke marrë në konsideratë, për blerjet e reja cilësore, kërkesat aktuale për funksionalitet zgjerim cilësi e performancë si dhe shërbimet profesionale të kërkuara për teknologjite ekzistuese, ofrimit të produkteve të reja, karakteristikat e duhura bashkëkohore teknologjike, standardet e duhura kombëtare dhe ndërkombëtare, në përputhje me parashikimet e nenit 4, pika 38/b dhe nenit 36, të Ligjit Nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, si dhe nenit 40, pika 2, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021, “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”. Në çdo rast ku ka qenë e mundur është përdorur termi “ose ekuivalent” për të qenë gjithmonë në konformitet me zbatimin e legjislacionit të prokurimeve publike dhe akteve nën-ligjore në zbatim të tyre.*